

Njoftim për përqendrim me të cilin 4iG Űr és Védelmi Technológák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, Hungari do të fitojë kontroll mbi N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, Hungari, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság, Hungari dhe VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hungari

(lënda nr. 08-159 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **4iG Űr és Védelmi Technológák Zártkörűen Működő Részvénytársaság** me seli të regjistruar në rr. Krisztina körút nr. 39, 1013 Budapest, Hungari do të fitojë kontroll mbi N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság me seli të regjistruar në rr. Asztalos Sándor út. 2, 1087 Budapest, Hungari, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság me seli të regjistruar në rr. Szent István út 16. 3. em. 313. ajtó, 8100 Várpalota, Hungari dhe **VAB Korlátolt Felelősségű Társaság** me seli të regjistruar në rr. Asztalos S., út. 2, 1087 Budapest Hungari, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

-4iG Űr és Védelmi Technológák Zártkörűen Működő Részvénytársaság është shoqëri aksionare veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e kompanive holding, telekomunikimet dhe integrimi i sistemeve të IT-së, teknologjitë për hapësirë dhe mbrojtje, shërbimet radio-difuzive dhe satelitore.

4iG Űr és Védelmi Technológák Zártkörűen Működő Részvénytársaság ka një person juridik të lidhur në Maqedoninë e Veriut, dhe kjo është **Shoqëria për shërbime komunikimi ONE MACEDONIA TELEKOMUNIKIME SHPKNJP Shkup**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në rr. Crvena Voda numër 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria prioritare e së cilës është – veprimtaritë e telekomunikimeve pa tela

-N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság është shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Asztalos Sándor út. 2, 1087 Budapest, Hungari, veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e kompanive holding, respektivisht menaxhimi i pronësisë së aseteve të ndryshme të industrisë së mbrojtjes. Portofoli i tyre përfshin kompanitë kryesore hungareze të industrisë së mbrojtjes (prodhimin e armëve të zjarrit dhe municionit, automjeteve ushtarake, mirëmbajtjen dhe komponentët për aviacion, etj.).

N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság nuk ka persona të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

-Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli të regjistruar në rr. Szent István út 16. 3. em. 313. ajtó, 8100 Várpalota, Hungari. Shoqëria është pjesë e një grupi që në nivel global është aktiv si zhvillues, prodhues dhe furnizues i sistemeve të mortajave. Asortimenti i produkteve përfshin municion për mortaja, sisteme armatimi, pajisje ndihmëse terreni, sisteme për shënjestrim dhe synim.

Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nuk ka persona të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

-VAB Korlátolt Felelősségű Társaság është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli të regjistruar në rr. Asztalos S., út. 2, 1087 Budapest Hungari, veprimtaria kryesore e së cilës është zhvillimi i projekteve ndërtimore.

VAB Korlátolt Felelősségű Társaság nuk ka persona të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant të merret *tregu i pajisjeve/sistemeve mbrojtëse ushtarake për të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut*.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.11.2025

Shkup